



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 192

Tiranë – E premte, 3 nëntor 2017

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 168, datë 26.10.2017	Mbi miratimin e një ndryshimi në vendimin e ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, “Mbi miratimin e rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”.....	9447
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 169, datë 26.10.2017	Mbi fillimin e procedurës për rishikimin e “Rregullores për organizimin funksionimin dhe procedurat e ERE-s”.....	9448
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 170, datë 26.10.2017	Mbi licencimin e shoqërisë “Bindi” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	9449
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 171, datë 26.10.2017	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Sima - Com” sh.p.k. për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-I “Meshurdh”, me fuqi të instaluar 1.3 mw.....	9449
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 172, datë 26.10.2017	Mbi licencimin e shoqërisë “Afrimi K” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-I “Thanzë”, me fuqi të instaluar 2 mw.....	9450
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 173, datë 26.10.2017	Mbi licencimin e shoqërisë “Smart Trade & Consulting” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	9451
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 174, datë 26.10.2017	Mbi licencimin e shoqërisë “Energy Financing Team Tërana” sh.p.k. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.....	9451
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 175, datë 26.10.2017	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “HEC-i Dragostunje” sh.p.k., për lënien peng të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme që do t’i përkasin “HEC-i Dragostunje” (asete që do t’i shërbejnë veprimtarisë së licencuar; ndërtesa, pajisjet dhe gjithë sistemin e prodhimit dhe shpërndarjes), në favor të bankës Societe Generale Albania sh.a.....	9452

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 176, datë 26.10.2017	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e kontratës së shërbimit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror ndërmjet shoqërisë “Albgaz” sh.a dhe “Albpetrol” sh.a.....	9453
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Sandri Pina.....	9454

**VENDIM****Nr. 168, datë 26.10.2017**

**MBI MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI
NË VENDIMIN E ERE-S NR. 103, DATË
23.6.2016, “MBI MIRATIMIN E
RREGULLORES PËR PROCEDURAT E
BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE
PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NË
RRJETET E SHPËRNDARJES DHE TË
TRANSMETIMIT DHE PËR BLERJEN
DHE SHITJEN E ENERGJISË
ELEKTRIKE PËR TË SIGURUAR
PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE TË
SHËRBIMIT PUBLIK”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe nenit 16 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.10.2017, pasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike në lidhje me kërkesën e shoqërisë OSHEE sh.a për rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, “Mbi miratimin e rregullores së procedurave të blerjes së energjisë elektrike nga shoqëria OSHEE sh.a. te shoqëritë e licencuara për tregtimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 22112 prot., datë 4.10.2016, ka mbërritur në ERE kërkesa e OSHEE sh.a. për një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, mbi miratimin e “Rregullores së procedurave të blerjes së energjisë elektrike nga shoqëria OSHEE sh.a. te shoqëritë e licencuara për tregtimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”.

- Mbështetur në nenin 19, germa “I”, e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ERE miraton, me propozim të të licencuarve, rregullat për: “i” shitjen, blerjen dhe shkëmbimin e energjisë elektrike, që kryhen nga prodhuesit

dhe furnizuesit, të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik; ii) sigurimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes.

- ERE miratoi vendimin nr. 169, datë 31.10.2016, “Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e disa ndryshimeve në vendimin e ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, “Mbi miratimin e rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”.

- ERE me shkresën nr. 771 prot., datë 2.11.2016, i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, OSHEE sh.a., OST sh.a., KESH sh.a., Autoritetit të Konkurrencës, AAES, si dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, dhe ka kërkuar opinionet e tyre në lidhje me ndryshimet e propozuara nga OSHEE sh.a.

- Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike AAES, me shkresën nr. 18 prot., datë 17.11.2016, propozon që në rast të amendimit të nenit 20 të kësaj rregulloreje, në lidhje me faturimin dhe pagesat, palët të zbatojnë dispozitat e nenit 13 të kontratës EFET.

- Shoqëria KESH sh.a., me shkresën me nr. 8789/1 prot., datë 21.11.2016, bën të ditur se nuk e sheh përfshirjen e kësaj shoqërie në këtë rregullore.

- Autoriteti i Konkurrencës bën me dije se, ndryshimet e propozuara nuk bien në kundërshtim me ligjin nr. 9121 prot., datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

- Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, në korrespondencë elektronike zyrtare, protokolluar në ERE më nr. 642/1 prot., datë 13.10.2017, është shprehur se është e nevojshme që neni 20 i kësaj rregulloreje të ketë parashikime në lidhje me afatin e pagesave të tilla që të reflektojnë kostot financiare efektive të kompanisë.

- OSHEE sh.a nga ana e saj ka sqaruar se afati i faturimit të pagesave duhet të ndryshojë nëse ky nen qëndron në rregullore duke e çuar në 90 ditë.

- Me vendimin nr. 122, datë 8.8.2017, të bordit të ERE-s, është vendosur që rregullorja e procedurave të blerjes së energjisë elektrike nga shoqëria OSHEE sh.a. te shoqëritë e licencuara për tregtimin e energjisë elektrike për mbulimin e



humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik, hyn në fuqi brenda datës 30.9.2017.

- OSHEE sh.a. ka garantuar se procedurën për blerjen e energjisë në treg të parregulluar për muajin nëntor 2017 do ta zhvillojë nëpërmjet platformës *online* të blerjes së energjisë.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Neni 20 i Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, ndryshon si më poshtë:

a) I gjithë procesi i rakordimit të sasive të energjisë elektrike të livruar mes palëve, vlerave përkatëse financiare, si dhe faturimi duhet të mbyllet brenda 10 ditëve kalendrike nga data e fundit e livrimit të energjisë elektrike. Paga do të bëhet nga blerësi brenda 90 ditëve nga dita e fundit e livrimit.

b) Çdo ditë ose periudhë livrimi më e vogël se kaq, në rast se periudha e livrimit për blerjen është më e shkurtër, duhet të jetë e paraqitur si zë më vete në faturë. Faturimi do të gjenerohet nga platforma IT e ngritur nga shitësi që kryen procedurat e shitjes së energjisë elektrike sipas kësaj rregulloreje, dhe do t'i faturohet blerësit.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendrike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 169, datë 26.10.2017

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RISHIKIMIN E “RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE PROCEDURAT E ERE-S”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 110, pika 2 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë Elektrike”, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.10.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për rishikimin e “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, të përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Kjo rregullore ka nevojë për përmirësime dhe saktësime në referencë të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rishikimin e “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.96, datë 17.6.2016.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendrike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti



VENDIM

Nr. 170, datë 26.10.2017

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“BINDI” SHPK NË AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe neneve 4, pika 1, germa “e” dhe 5, pika 1, germa “e”; 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.10.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Bindi” sh.p.k., të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Bordi i ERE-s, me vendimin nr.146, datë 18.9.2017, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë

“Bindi” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

Aplikimi i shoqërisë “Bindi” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni tekniko-ekonomik (neni 9, pika 4.8, germat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Bindi” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 171, datë 26.10.2017

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË
SHOQËRISË “SIMA - COM” SHPK, PËR
LICENCIM NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA HEC-I “MESHURDH”,
ME FUQI TË INSTALUAR 1.3 MW**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a” dhe 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.10.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Sima - Com” sh.p.k.,

konstatoi se:

Shoqëria “Sima - Com” sh.p.k., me shkresën nr. 657 prot. i ERE-s, datë 6.10.2017, ka paraqitur në ERE kërkesën për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-i Meshurdh, me fuqi të instaluar 1.3 mw.



Aplikimi i shoqërisë “Sima - Com” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat (“a”, “b”, “d”, “e”, “f” dhe “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “c” dhe

- “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për HEC (neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3, germat “a”, “c” dhe “d”; 4.1.4; 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Një diagram elektrik në format A1 të agregateve dhe bllokut të transformimit, ku të evidentohen qartë pika e lidhjes me sistemin dhe pika e matjes (neni 9, pika 4.1.3, germa “b”); do të njoftohet subjekti që, në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë këto në ERE brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Sima – Com” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-i “Meshurdh”, me fuqi të instaluar 1.3 mw.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 172, datë 26.10.2017

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “AFRIMI K” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-I “THANZË”, ME FUQI TË INSTALUAR 2 MW

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”; 13, 14 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe neni 20, pika 2 e “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.10.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë “Afrimi K” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-i “Thanzë”, me fuqi të instaluar 2 mw, për një afat 30-vjeçar, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, konstatoi se:

Me vendimin e bordit nr. 138, datë 6.9.2017, ka filluar procedura për licencimin e shoqërisë “Afrimi K” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-i “Thanzë”, me fuqi të instaluar 2 mw.

Aplikimi i shoqërisë “Afrimi K” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat (“a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për HEC (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Afrimi K” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-i “Thanzë”, me fuqi 2 mw, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 173, datë 26.10.2017

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“SMART TRADE & CONSULTING”
SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “e”; 5, pika 1, germa “e”; 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.10.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë “Smart Trade & Consulting” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Bordi i ERE-s me vendimin nr. 166, datë 12.10.2017, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Smart Trade & Consulting” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

Aplikimi i shoqërisë “Smart Trade & Consulting” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germa “a”, “b” “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germa “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/10, germa “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Smart Trade & Consulting” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 174, datë 26.10.2017

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“ENERGY FINANCING TEAM TIRANA”
SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “d”; 5, pika 1, germa “d”; 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.10.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë “Energy Financing Team Tirana”



sh.p.k. në aktivitetin e furnizimit të Energjisë Elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Shoqëria “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., me shkresën e datës 6.9.2017, protokolluar në ERE me nr. 605 prot., datë 6.9.2017, ka paraqitur në ERE kërkesën për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.

Bordi i ERE-s me vendimin nr. 148, datë 28.9.2017, ka vendosur mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.

Aplikimi i shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gerrat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gerrat (“a/b”, “c” “d” dhe “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gerrat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, gerrat “a” “b”, “c”, “e”, “f”, “a.1”, “b.1”, “c.1”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5- vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 175, datë 26.10.2017

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “HEC-I DRAGOSTUNJE” SHPK, PËR LËNIEN PENG TË ASETEVE TË LUAJTSHME DHE TË PALUAJTSHME QË DO T’I PËRKASIN “HEC-I DRAGOSTUNJE” (ASETE QË DO T’I SHËRBEJNË VEPRIMTARISË SË LICENCUAR; NDËRTESA, PAJISJET DHE GJITHË SISTEMIN E PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES), NË FAVOR TË BANKËS SOCIETE GENERALE ALBANIA SHA

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20, germa “a”, dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në zbatim të neneve 6; 7 dhe 8 të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr.119, datë 21.7.2016; pikave 1.3 dhe 1.6 të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, gjithashtu dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.10.2017, mbasi shqyrtoi relacionin mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “HEC-i Dragostunje” sh.p.k., për lënien peng të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme që do t’i përkasin “HEC-i Dragostunje”, (asete që do t’i shërbejnë veprimtarisë së licencuar; ndërtesa, pajisjet dhe gjithë sistemin e prodhimit dhe shpërndarjes), në favor të bankës Societe Generale Albania sh.a , të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “HEC-i Dragostunje” sh.p.k plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, gerrat: “a”, “b”, “c”, “e”, “f”, “g”, “j”, “k”, është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:



- Nenin 7, pika 1, germa “d” (një përshkrim të kandidatit të propozuar për transferim aset, që përfshin informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e shoqërisë që përfshihet në transaksion të tri viteve të fundit dhe të vitit të fundit, kur shoqëria ka më pak se 3 vjet që është krijuar, gjendjen financiare;) dhe “h” (marrëveshje paraprake e nënshkruar midis palëve në një nga format e parashikuara nga ligji, për transferimin e aseteve. Marrëveshja duhet të përmbajë një listë të detajuar të aseteve që kërkohet të transferohen); “i” deklarata me shkrim e personit tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shprehë gatishmërinë e tij për të garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit.

- Nenin 7, pika 3 (subjektet konçensionare të licencuara, të cilat aplikojnë për miratimin e transferimit të aseteve në ERE, duhet të shprehin në formë të shkruar, në marrëveshjen e transferimit të aseteve, detyrimet me të cilat ngarkohen për shkak të marrëveshjes së konçensionit e pjesët që transferojnë te përfituesi...), do të njoftohet subjekti që t'i paraqesë në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Hec-i Dragoshtunje” sh.p.k. për lënien peng të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme që do t'i përkasin “Hec-i Dragoshtunje”, (asete që do t'i shërbejnë veprimtarisë së licencuar; ndërtesa, pajisjet dhe gjithë sistemin e prodhimit dhe shpërndarjes) në favor të bankës Societe Generale Albania sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut do të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 176, datë 26.10.2017

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË SHËRBIMIT TË TRANSMETIMIT DHE SHPËRNDARJES SË GAZIT NATYROR NDËRMJET SHOQËRISË “ALBGAS” SHA DHE “ALBPETROL” SHA

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 35 dhe 36, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”; nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.10.2017, mbasi shqyrtoi relacionin mbi fillimin e procedurës për miratimin e kontratës së shërbimit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror ndërmjet shoqërisë “Albgaz” sh.a. dhe “Albpetrol” sh.a.,

konstatoi se:

- Shoqëria “Albgaz” sh.a. ushtron aktivitetin si operator i sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror në Shqipëri, në zbatim të VKM-së nr. 848, datë 7.12.2016, “Për krijimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. dhe për caktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërisë “Albpetrol” sh.a dhe “Albgaz” sh.a.”.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 82, datë 26.5.2017, ka miratuar certifikimin paraprak të shoqërisë “Albgaz” sh.a në cilësinë e operatorit të kombinuar të gazit natyror dhe me vendimin nr. 90, datë 7.6.2017, ka miratuar tarifën e përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sh.a. për periudhën 5.1.2017 – 20.9.2017”, ndryshuar me vendimin nr. 155, datë 28.9.2017.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 127, datë 16.8.2017, ka filluar procedurën për licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror.

- ERE ka marrë dijeni për draftimin e kësaj kontrate me shkresën e “Albgaz” sh.a nr. 23 prot., datë 3.4.2017.

Me shkresën nr. 107 prot., datë 9.10.2017, shoqëria “Albgaz” sh.a i është drejtuar ERE-s për miratimin e kontratës së shërbimit të transmetimit dhe shpërndarjes midis “Albpetrol” sh.a dhe “Albgaz” sh.a.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e kontratës së shërbimit të transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit natyror ndërmjet shoqërisë “Albgaz” sh.a. dhe “Albpétrol” sh.a.

2. Drejtoria e e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

KËRKESË

Shtetasja Vangjeli Pina kërkon, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, shpalljen të zhdukur të shtetasit Sandri Pina dhe caktimin e saj si kujdestare për administrimin e pasurisë së tij.

KËRKUESE
Vangjeli Pina

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa: Rr "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel/fax +355 4 24 27 004 Tel +355 4 24 27 006

Çmimi 84 lekë